




REPUBLIKA E KOSOVës		PUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT		ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	2-D/DPK	Nr. Prot.	01-2683/14
Dep.		Prot. No.	
Nr. l. faq.		Data	18-07-2014
Broj stranica	02	Datum	
Nr. pages		Dat.	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 15.07.2014, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-2011/14, për z. Ali Krasniqi, ish Anëtar i Kuvendit Komunal të Kaçanikut, për shkak se nuk ushtron më funksion publik

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funksionit Publik për zyrtarin e lartë, z. Ali Krasniqi, ish Anëtar i Kuvendit Komunal të Kaçanikut, dhe njëkohësisht, person i autorizuar në një biznes privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Në rastin e lartëpërmendur, zyrtari i lartë z. Krasniqi është hetuar për situatë të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik. Fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, pas së cilës ai është kontaktuar nga zyrtarët e Agjencisë me ç'rast është kuptuar se tashmë ish zyrtari i lartë z. Krasniqi nuk e ushtron më funksionin e Anëtarit të Kuvendit Komunal në Kaçanikut, dhe po ashtu nuk ka asnjë funksion tjetër publik.

Duke u bazuar në Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit konsiderojmë se nuk kemi situatë të shkeljes së dispozitave të këtij Ligji, prandaj pushojnë hetimet për Konflikt Interesi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Hasan Preteni
Drejtore Agjencisë kundër Korrupsionit

